



Republika e Kosovës
Rpublika Kosova/ Republik of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragaš / Daragas Municipality

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 par.1 pika 1.1 të ligjit nr.03/L-149 për Sherbimin Civil të Kosovës, neni 3 dhe 4 të Rregullores nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Sherbimin Civil dhe në bazë të kërkesës së Drejtorit për Mirëqene Sociale KK Dragash , të drejtuar në zyrën e shërbimit te personelit KK Dragash nr.03.111-7782 për pranimin e një punëtori ne Qendren per Pune Sociale K Dragash,zyra e Shërbimit të Personelit pranë K Dragash publikon këtë ;

K O N K U R S
Për minoritete

Pozicioni; Zyrtar i Sherbimeve Sociale MSK/470

Niveli I pagës; K.7

Periudha e kontratës; 1(një) vjeçare me mundësi vazhdimi

Vendi I punës; QPS-K.Dragash

Orët e punës;40 ore ne javë

Përgjegjës mbikëqyrës ;Drejtori i QPS-së Dragash dhe Drejtorit për Shëndetsi dhe Mirqenje Sociale

Përshkrimi i punës dhe përgjegjësitë

- ❖ Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;10%
- ❖ Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- ❖ Trajton rastet dhe përgatit raport për gjykatën për heqjen e zotësisë se veprimit te personave te paaftë për të vepruar;
- ❖ Trajton mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindor, birësimin, kujdestarin dhe strehimin e përkohshëm familjar;
- ❖ Trajton rastet e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikumente, rastet e angazhimit të fëmijëve në punët e rënda dhe të lënies pa kujdes ;
- ❖ Monitoron rastet e dhunës në familje dhe angazhohet në përmirësimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe bënë propozimin për besimin e fëmijëve ne raste të shkurorëzimit të prindërve dhe përcjell realizimin e kontakteve ;
- ❖ Përkujdeset edhe për kategoritë tjera të personave me nevojë, të moshuarit, fëmijët me aftësi të kufizuar te përhershme, personave qe konsumojnë substanca narkotike, alkoolike etj.;
- ❖ Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathësit kryesore të kërkuara

- ❖ Diploma universitare(juridik,psikologji,pedagogji,sociologji dhe fak.per pune sociale) minimum 2 vite përvojë pune profesionale
- ❖ Njohuri dhe përvojë në fushën e çështjeve sociale
- ❖ Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- ❖ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomand. dhe këshillave profesionale;
- ❖ Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- ❖ Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Afati i Konkursit;Konkursi mbetet i hapur 15 nga dita e shpalljes,kërkesat e parashtruara pas këti afati nuk do te pranohen.Aplikacionet për aplikim merren në zyrën e Shërbimit të Personelit nr.9 K.Dragash.

Sherbimi i Personelit